

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dalip Bega kryetar, Mejreme Zekaj dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek.juridike Zymrije Çunaku, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Murteza Osdautaj nga Prishtina, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr.regj.14832/12, të datës 30.06.2012, në bazë të nenit 31 at. 3-39 konform nenit 221 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 22.10.2012, merr

AKTVENDIM

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA E KOSOVES		AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.		Nr. Prot.	
Dep.	DPK/DMP	Br Prot.	
Nr. I tta		Prot No	03-4149/12
Proj. shranica		Data	
Nr. pages	02	Datum	14.11.2012
		Date	

Ankesa e paraqitur pjesërisht është e **BAZUAR** NDRYSHOHET aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë ashtu që të pandehurit Murteza Osdautaj nga Prishtina, për të njëjtën kundërvajtje i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 1000.-€ (Njëmijë euro), të cilën gjobë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, në të kundërtën gjoba e shqiptuar do t,i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 (Tridhjetë) dite.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

Arsyetim

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, sipas aktvendimit Nr.regj.14832/12 të datës 30.06.2012, të pandehurin Murteza Osdautaj nga Prishtina, e ka shpallur përgjegjës sepse si Zyrtar iu Lartë Publik, në pozitë të Drejtorit të Departamentit të Shkencës dhe Teknologjisë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nuk e ka bërë deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencionin Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor deri më 31.03.2012, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkua me nenin 17 parag. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 1500.-€ (Njëmijë e pesëqind euro), duke e obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5.-€ (Pesë euro).

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri ka paraqitur ankesë në të cilën përpos tjerash thekson se me kohë përmes E-mail adresës është njoftuar për plotësimin e formularit për deklarin pasurie por ka qenë në udhëtim zyrtar dhe më 05 mars 2012 ka mund ta shef, se ka qenë i angazhuar me aktivitete të rëndësishme shtetërore sidomos në muajin mars 2012, se nuk e ka neglizhuar çështjen e as nuk e ka nënvlerësuar aktin e deklarinimit të pasurisë. E konteston theksimin në arsyetim të aktvendimit se dënimi i është shqiptuar në përputhshmëri me lartësinë e Evropës, se është i vetmi i punësuar në familje, jeton me qira në Prishtinë dhe se dënimi i shqiptuar do t'ia rrezikonte ekzistencën e familjes. Kërkon nga Gjykata e Lartë që të merren parasysh angazhimet e jashtëzakonshme të tij që ka patur në muajin mars, gjendjen e tij ekonomike dhe situatën familjare dhe propozon që të lirohet nga përgjegjësia kundërvajtëse.

Kolegji i kësaj gjykate duke e vlerësuar ankesën, aktvendimin e atakuar, deklarinimit e të pandehurit të dhënë në seancën e shqyrtimit pranë gjykatës së shkallës së parë më datë 06.06.2012, por duke u bazuar edhe në bazë të shkresave tjera të lëndës, konstatoi se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer veprën kundërvajtëse siç është përshkruar në dispozitivin e aktvendimit të atakuar për çka e ngarkon kërkesa për fillimin dhe zhvillimin e procedurës kundërvajtëse dhe mban përgjegjësi

kundërvajtëse, por nga arsyetimi i aktvendimit nuk vërehet se i janë marrë parasysht apo jo, rrethanat të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i madh ose më i vogël etj. të cilat parashihen sipas nenit 7 të LK-së, kështu që kolegji duke marrë parasysht të gjitha rrethanat e parapara në nenin 7 të LK-së, se i pandehuri e ka pranuar kundërvajtjen, se më datën 06.04.2012, e ka përmbushur obligimin e tij dmth. e ka plotësuar formularin për deklarimin e pasurisë vetëm 6 ditë mbas kalimit të afatit të obliguar ligjor e që në mas të madhe e zvogëlon përgjegjësinë e të pandehurit, se më parë nuk ka kryer kundërvajtje por duke u bazuar edhe në gjendjen ekonomike dhe familjare të të pandehurit, në vështrim të nenit 9.1 të LK-së e ndryshoi aktvendimin e atakuar vetëm sa i përket gjobës së shqiptuar ashtu që për të njëjtën kundërvajtje i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 1000.-€ si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa u tha më lartë, në vështrim të nenit 221 të Ligjit mbi Kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,

GJL.nr.1123/2012 të datës 22.10.2012.

SEK. JURIDIKE,
Zymrije Cunaku

